

SHENIMET SHPJEGUESE

2. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

a. Menyra e Prgatitjes se Pasqyrave Financiare

P F te shoqerise jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me SKK, te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin 9477 date 09.02.2006 dhe ne "Standartet Kombetare te Kontabilitetit" (SKK) te permiresuara Pasqyrat Financiare jane pregatitur duke ndjekur e zbatuar Politikat Kryesore Kontabel si : politika per njohjen e aktiveve,e detyrimeve , e te drejtave ,e te ardhurave e shpenzimeve si dhe vleresimin e tyre Gjithashtu gjate prgatitjes se Pasqyrave Financiare jane pasur parasysh Parimet e meposhteme : Parimi i te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise se veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit.

Karakteristikat cilesore te prgatitjes se Pasqyrave Financiare jane ato qe e bejne informacionin e dobishem per perdoruesin.Karakteristikat kryesore qe jane mbajtur parasysh gjate hartimit te Pasqyrave Financiare jane : Kuptueshmeria,Rendesia , Materialiteti,Besueshmeria dhe Krahasueshmeria

b. Rregullat per vleresimin Mjeteve Monetare

Mjetet monetare perfaqesojne Likujditetet e njesise ekonomike ne arke dhe ne banke ,ne llogari rrjedhese , investime ne tregun e parase dhe tregje te tjera shume likuide duke ndjekur politiken kontabel te Vleres se drejte ne zbatim te SKK 3

c. Rregullat per vleresimin e Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera

Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera ,kerkesa te arketueshme afatshkurtera letra me vlere dhe investime te tjera financiare jane te pasqyruara mbi bazen e vleres se faturave origjinale te leshuara klienteve apo te dokumentave te tjere kontabel.Politika kontabel e ndjekur per aktivet financiare afatshkurtera eshte sipas Kosos se amortizuar qe eshte e barabarte me vleren nomonale te kerkeses per arketim minus zhvleresimin n.q.s. ka) sipas SKK 3.

d. Rregullat per vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.

Gjendjet e inventarit klasifikohen ne Lende te para ,Prodhim ne proces,Produkte te gatshme,Mallra per rishitje, Parapagesa per rishitje. Politika e ndjekur eshte ajo e Vleresimit me vleren me te ulet mes kosos dhe vleres neto te realizueshme.Kosto eshte llogaritur per cdo ze duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar(SKK 4). Menyra e Vleresimit te Inventareve permbledh shpenzimet e blerjes se lendeve te para,mallrave e materialeve , shpenzimet e transportit,dhe shpenzimet e tjera deri ne magazinimin e tyre.

e. Rregullat per vleresimin e Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra perfaqesojne shpenzimet e bera gjate vitit financiar por qe u perkasin periudhave te ardhshme te njesise ekonomike.Per to eshte ndjekur politika kontabel kosto minus zhvleresimin nqs ka te tille . pasqyruar sipas percaktimit e ne zbatim te SKK 1.

f. Rregullat per vleresimin e Aktiveve afatgjata materiale


Aktivitet afatgjata materiale te te ndara ne zerat si toka,ndertesa,makineri e paisje,paisje zyre e informatike te klasifikuara sipas SKK 5 jane perfshire ne pasqyrat financiare duke ndjekur politiken kontabel kosto e blerjes.

g. Rregullat per vleresimin e Huave e Parapagimeve

Huate dhe parapagimet te klasifikuatra sipas zerave te pagueshme ndaj furnitoreve,ndaj punonjesve,detyrime tatimore, hua te tjera jane vleresuar sipas faturave te blerjes e dokumentave te tjere origjinale kontabel, sipas SKK 3.

h. Rregullat per vleresimin e Kapitalit

Kapitali i njesise ekonomike vleresohet sipas vleres kontabel te kapitalit aksionar te emtuar ne krijim te njesise ekonomike,rezervave te krijuara ne perputhje me statutin e njesise ekonomike,ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per shoqerite Tregtare" ose ndonje ligj tjetër te aplikueshem.Fitimet e pashpermdara qe perbehet nga fitimet



e akumuluaru minus pagesat e bera ose te perdorura. Fitimet e pasqerimit ndikuar nga ndikimet ne politikat kontabel (skk 1) korigjimi i gabimeve si dhe rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale (SKK 5). Fitimi ose humbja e vitit financiar e barabarte me fitimin ose humbjen e raportuar ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.

i. Rregullat e vleresimit te te Ardhurave

Te ardhurat perfaqesojne shitjet neto e rrjedhimisht te ardhurat e perftuara nga kryerja e punimeve ne ndertim gjate periudhes kontabel te vlersuara sipas SKK 8 dhe te produktit ne proces ndertimi te vlersuar sipas SKK 4. Rregjistrimi sipas mases se realizimit te tyre dhe te lidhjes qe kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pamvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes.

j. Rregullat e vleresimit te Shpenzimeve direkte

Shpenzimet e njesise ekonomike te vitit financiar perfaqesojne shpenzimet e blerjes te mallrave, lendeve te para dhe sherbimeve te konsumuara per veprimtarine paresore, koston e sherbimeve kryesore te vlersuara me cmimet e blerjes e te vertetuara me fatura origjinale e dokumenta te tjera kontabel, shpenzime qe lidhen ne menyre direkte me mallrat ose produktet e destinuar per shitje. Pagat shperblimet dhe kompesimet monetare, sigurimet shoqerore te paguara nga njesia ekonomike te llogaritura mbi pagat qe i perkasin periudhes kontabel pamvaresisht nga fakti nese ato jane paguar ose jo. Shpenzimet per amortizimin qe vijne nga renia ne vlere e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera qe jane shpenzimet e tjera te pa perfshira ne zerat e mesiperme por qe lidhen me veprimtarine kryesore te njesise ekonomike.

k. Rregullat e vleresimit te Shpenzimeve (Te Ardhurave) Financiare

Te ardhurat ose shpenzimet financiare jane klasifikuar ne te ardhura ose shpenzime nga interesat bankare, te ardhura (shpenzime) te interesi mbi hua, bono, marreveshje te qerese financiare etj. Te ardhura (shpenzime) nga ndryshimi i kursit te kembimit, te kerkesave per tu arketuar dhe detyrimeve per tu paguar si dhe gjendjet e likuiditeteve ne monedhe te huaj qe lidhen me veprimtarine financiare e investuese ne fund te periudhes financiare. Te ardhura te tjera (shpenzime) financiare rezultati nga financimet financiare afatshkurtera, rezultati nga interesi dhe dividendet, rezultati nga rivleresimi i vleres se drejte etj

l. Rregullat e vleresimit te Tatimit mbi Fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin vleresohen ne baze te rezultatit te periudhes financiare i llogaritur ne perputhje me dispozitat per tatimin mbi te ardhurat ne Republiken e Shqiperise. Shpenzimet per tatimin mbi fitimin perfshije gjithë detyrimet per tatimin mbi fitimin e periudhes financiare

2. ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me ligjin nr 9228 date 29 04 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin nr 9477 date 09.02.2006. dhe me SKK 2. Shoqeria ka ndertuar nje plan te llogarive me programin financa5.

Hartuesi

Qiriako Mita



Administrator

Izder Avdulla

